



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2649/2 prot

Datë 31.10.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-80464-09-18-2023, me objekt: Loti 1 “*Blerje mobilje për kopshe dhe cerdhe*”, me fond limit 4.188.533 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Klame” SHPK, me NIPT (K21518003F), me adresë: Njësia Administrative Nr.11, Kodër Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kat1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz, me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza” Nr.492, Kamëz, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Murati D” SHPK, me NIPT (K42003004T), me adresë: Rruga e Kavajës, Ish-Kombinati Ushqimor, Godinë 1- katëshe, Tiranë

Në datën 30.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3548, si dhe nr. protokolli 2649/2023 datë 30.10.2023 e operatorit ekonomik “Klame” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-80464-09-18-2023, me objekt: Loti 1 “*Blerje mobilje për kopshe dhe cerdhe*”, me fond

limit 4.188.533 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Klame” SHPK me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3548, si dhe nr. protokolli 2649/2023 datë 30.10.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Murati D” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Murati D” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

[...]

**Shtojca 7**

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

## **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

### **1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij ndër të tjera pretendon se:

[...] 5. Nga sa më sipër, nuk mjafton që një operator ekonomik të bëjë një deklaram vullnetar në QKB dhe të konsiderohet se ai ushtron veprimtari në fushën e objektit të këtij prokurimi.

6. Legjislacioni ka paraparë kushte plotësimi I të cilave është detyruar për secilin operator ekonomik që dëshiron të ushtrojë aktivitet në fushën objekt prokurimi. Është ministria përkatëse e linjës dhe Agjencitë vartëse e tyre që bëjnë shqyrtimin e kërkesave të shoqëive që janë të interesuara në këtë fushë dhe më pas nëse këto të fundit I përmbushin kërkesat ligjore I pajisin ato me Leje përkatëse që I lejon ato të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit të drurit dhe mobilimit etj.

Në këto kushte, shoqëria e referuar më sipër “Murati D” shpk, nuk është e licensuar/lejuar ligjërisht të ushtrojë aktivitet në fushën e veprimtarisë objekt prokurimi, për rrjedhojë duhet të skualifikohet.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 31.10.2023.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**